



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 732/2022**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 të procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të kërkesës së datës: 29.11.2022, të parashtruar nga OE "FAMIS CO-HC" Sh.A, me seli në Suharekë, për tërheqje nga ankesa e parashtruar me dt: 02.12.2022 me nr. 732/2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit :616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 13 Dhjetor 2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e datës: 12.12.2022 e parashtruar nga operatori ekonomik "FAMIS CO-HC" Sh.A, me seli në Suharekë, për tërheqje nga ankesa e parashtruar me dt:02.12.2022 me nr. 732/2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit :616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë.

**I LEJOHET** autoritetit kontraktues Kuvendit Komunal Prishtinë që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit: 616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër .

Meqenëse parashtruesi i ankesës tërhiqet nga ankesa dhe pretendimet ankimore në këtë fazë, duke u bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Obligohet, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "FAMIS –CO-HC" Sh.A, me seli në Suharekë, me dt:02.12.2022( protokoll 732/2022), ka parashtruar ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së –Njoftimi B58 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit :616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511 , iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar në shkelje të nenit 1,6,7,59,65,69 dhe 72 të LPP-së.

Përfaqësuesi i OE ankues me datën: 12.12.2022, ka dërguar në adresë të OSHP-së e-mail, Njoftim ku ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, me nr. 732/2022 , lidhur me tenderin me titull "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit :616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511 , iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, i nijeti OE ka konfirmuar se me datën 08.12.2022 ka tërhequr nga sistemi i e prokurimit ankesën e cekur si më lart.

OSHP ka verifikuar edhe në sistemin elektronik për ankesën në fjalë dhe pas verifikimit rezulton se edhe në sistemin elektronik e-prokurim figuron se ankesa e lartcekur është tërhequr.

Kryetarja e OSHP-së pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankues "FAMIS CO-HC"Sh.A,me seli në Suharekë,për tërheqje nga ankesa e parashtruar me dt: 02.12.2022 me nr. 732/2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës A –pjesa e parë" numër të prokurimit :616-22-7096-5-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 104 511 , iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, vendosi që të njëjtën ta aprovoj duke i lejuar AK Kuvendit Komunal Prishtinë që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

Kryetarja e OSHP-së pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE "FAMIS CO-HC" Sh.A, me seli në Suharekë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

pq

Kryetarja e OSHP-së  
Vjosa Gradinaj Mexhuani

